



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **31**

Prishtinë, më 27.11.2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Muharrem Nitaj, Besa Gaxherri, Liburn Aliu, Salih Zyba, Lutfi Zharku, Ganimete Musliu, Etem Arifi dhe Danush Ademi.

Munguan: Salih Salihu, Andin Hoti dhe Sergjan Mitroviç.

I ftuar: Bislim Zogaj, drejtor i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës (AMKMK).

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Muharrem Nitaj**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit më 20.11.2018;**
- 3. Shqyrtimi i gjendjes aktuale të komplekseve memoriale në Kosovë, i ftuar drejtori i AMKMK;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit më 20 nëntor 2018

Muharrem Nitaj, kryetar, konstatoi se me 5 vota për dhe 1 abstenim, u miratua procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 20.11.2018.

3. Shqyrtimi i gjendjes aktuale të komplekseve memoriale në Kosovë, i ftuar drejtori i AMKMK

Muharrem Nitaj, kryetar, njoftoi se në mbledhjen e mbajtur më 6 nëntor 2018, është diskutuar për gjendjen e komplekseve memoriale në Kosovë, ku i ftuar në mbledhje ishte drejtori i kësaj agjencie, z. Bislim Zogaj, dhe pas debatit, komisioni është pajtuar që të përgatitet një raport më i detajuar financiar për të gjithë kompleksët memorialë, me informacionet shtesë. Pasi e falënderoi drejtorin për raportin e dërguar dhe pjesëmarrjen në mbledhje, ia dha fjalën.

Bislim Zogaj, drejtor i AMKMK-së, për raportin financiar tha se përmban planifikimin e buxhetit për vitin 2018 dhe shpenzimet deri më 22 nëntor 2018, si dhe kërkesën për rialokimin e mjeteve prej 2,715 mijë euro, ndërsa në pjesën e dytë është paraqitur raporti i plotësuar financiar, për secilin projekt, që përfshin periudhën prej vitit 2013, nga koha kur është themeluar agjencia deri më tash.

U ndal shkurtimisht te disa projekte, duke lënë hapësirë që të bëhen pyetje nga deputetët. Te projekti në Mejë, përmendi disa probleme që janë zgjidhur tashmë dhe deri në fund të vitit do të përfundojë faza e parë që përfshin rregullimin e varrezave, ndërsa faza e dytë përfshin ndërtimin e amfiteatrit dhe muzeut, ndërsa projekti do të përfundojë në vitin 2019. Për projektin e Kompleksit Memorial “Adem Jashari”, tha se nga paslufta janë investuar 10 milionë euro, prej tyre afër 8 milionë euro deri në themelimin e agjencisë, ndërsa afër 2 milionë euro, prej themelimit të agjencisë e deri më tash. Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Kompleksin Memorial “Adem Jashari”, është kërkuar nga Qeveria themelimi i Komitetit ndërministror si obligim ligjor dhe pastaj të përzgjidhet kompania më e mirë për implementimin e projektit. Në fund, shtoi se për vitin 2019, parashihet buxheti prej 7.5 milion euro, ndërsa si agjenci, edhe pse është buxhetuar 2 milionë euro, do të kërkohej nga Komisioni për Buxhet, të rritet buxheti edhe për 5.5 milionë euro.

Besa Gaxherri, e përgëzoi drejtorin për përgatitjen e raportit, mirëpo potencoi se ka shpërputhje në mes planifikimeve dhe shpenzimeve buxhetore të projekteve gjatë vitit 2018. Ajo filloi me Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz, janë ndarë 1,000,000.00, ndërsa janë shpenzuar 213,417.39 euro, pastaj për mirëmbajtje janë ndarë 75,000.00 dhe janë shpenzuar 66,514.50 euro.

Duke pyetur, pse ekziston kjo shpërputhje mes ndarjes dhe shpenzimit të buxhetit edhe me projektet e tjera: *Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së, Marinë* (janë ndarë 212,000.00, ndërsa janë shpenzuar 23,012.80 euro); *Dëshmorët e Kombit, Vrellë* (janë ndarë 330,000.00, janë shpenzuar 227,786.96 euro); *Kompleksi në Mejë* (janë nda 200,000.00, janë shpenzua 51,674.76); *Kompleksi Memorial Demë Ahmeti, Podujevë* (janë ndarë 300,000.00, janë shpenzua 100,000.00 euro); *Ndërtimi i Varrezave të Dëshmorëve në fshatin Polac* (janë ndarë 250,000.00, janë shpenzuar 0 euro); *Kompleksi i Varrezave të Dëshmorëve të brigadës 121 të UÇK-së “Ismet Jashari – Kumanova”, Kleçkë* (janë ndarë 20,000.00, janë shpenzuar 0 euro); *Ndërtimi i Memorialit të Berishëve, Suharekë* (janë ndarë 300,000.00, janë shpenzuar 72,959.64 euro); *Bazamenti i shtatores Edmond Hoxha, Junik* (janë nda 50,000.00, janë shpenzua 0 euro); *Ndërtimi i infrastrukturës përcjellëse, hapja e shtigjeve dhe lapidarët përkujtimorë në fshatin Gorozhup në rajonin e Hasit* (janë ndarë 180,000.00, janë shpenzuar 73,343.57 euro); *Projekti i ish- Qendra e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, në Likovc* (janë ndarë 50,000.00, janë shpenzuar 13,204.90 euro); *Memoriali “Ibrahim Rugova”* (janë ndarë 200,000.00, janë shpenzuar 0 euro); *Ndërtimi i sheshit “Hasan Prishtina”* (janë ndarë 195,000.00, janë shpenzuar 0 euro).

Në përgjithësi, për vitin 2018, janë ndarë 5,760,000.00 euro, ndërsa janë realizua 2,964.412.95 euro d.m.th. as 50 % dhe shtoi se duhet pasur kujdes gjatë planifikimit të buxhetit, sepse kur nuk realizohet buxheti 80 %, është dështim. Ajo e përfundoi fjalën e vet, duke cituar vlerësimin e agjencisë për projektin e Memorialit “Ibrahim Rugova”, i cili duhet të jetë një projekt madhështor dhe i dinjitetshëm.

Lutfi Zharku, pyeti: Pse nuk janë shpenzuar mjetet më shumë se 20% të buxhetit për Kompleksin Memorial “Adem Jashari”, ku është problemi që nuk janë realizuar mjetet?

Liburn Aliu, u pajtua me pyetjet e parafolësve dhe u ndal te projekti i Kompleksit Memorial “Adem Jashari” dhe kërkoi më shumë informata për shpenzimet në periudhën 2006-2013 dhe shumën 8,5 milionë euro. Ndërsa, për periudhën 2013-2018, u interesua për projektet që kanë shpenzuar më së shumti, siç janë: *Ndërtimi i gypit të ujësjellësit (645 mijë euro)* dhe *Hartimi i projektit për konservimin e kompleksit (567 mijë euro)* dhe pyeti se a janë këto projekte të qasshme dhe publike.

Ganimete Musliu, e falënderoi drejtorin për raportin detal për secilin kompleks, edhe pse nuk ka qenë përgjegjësi e tij periudha kur nuk ka qenë drejtor. Po ashtu, u pajtua me pyetjet e parafolësve, sidomos e potencoi projektin për konservimin e kullave në Kompleksin Memorial “Adem Jashari” dhe shtoi se komisioni, por edhe ajo, vetë, disa herë gjatë viteve të fundit, në kohën e shqyrtimit të buxhetit, e ka ngritur çështjen e konservimit dhe gjithmonë janë ankuar, sepse nuk kanë mjete, ndërsa nëse ekziston një plan për konservimin dhe deri tash nuk është punuar fare për konservim, atëherë ndoshta vlen të formohet një komision hetimor parlamentar për këtë çështje.

Bislim Zogaj, iu përgjigj pyetjeve të parashtruara si vijon:

Në lidhje me shpërputhjen në mes parashikimit dhe shpenzimit të buxhetit për projektet, u pajtua me argumentet e paraqitura nga deputetët, mirëpo shtoi se Ligji për prokurimin nuk është në rregull, pasi që favorizon çmimin më të lirë. Në lidhje me këtë, ai paraqiti shembujt që edhe pse kanë ofruar çmim më të lirë, punët janë kryer: *Projektin ish- Qendra e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, në Likovc*, ku kanë qenë të planifikuara 50 mijë euro, ndërsa ofertuesi me 9 mijë euro d.m.th. 10% e shumës së planifikuar. *Projektin Memoriali i Berishëve në Suharekë*, të planifikuara kanë qenë 300 mijë euro, firma ka konkurrua me 180 mijë euro, ndërsa mjetet e mbetura (72 mijë euro) do të realizohen brenda vitit.

Projekti në Vrellë, ka përfunduar dhe mjetet janë shpenzuar dhe është një nga projektet më të mira; në *projektin në Mejë* edhe këto 51 mijë euro të mbetura janë për fazën e dytë dhe gjatë këtij muaji do të shpenzohen; në *Kompleksin Memorial “Demë Ahmeti”*, edhe pse puna ka filluar, shpronësimi nuk është bërë me kohë dhe këto mjete teprojnë; për *Varrezat në Polac* kanë qenë paraparë 250 mijë euro, ndërkohë FSK-ja ka marrë përsipër punën, ndërsa mjetet kanë kaluar në projekte të tjera; te *projekti “Ismet Jashari- Kumanova”*, pronarët nuk kanë lejuar punën pa shpronësim; *Memoriali në Gorozhup*, është në përfundim dhe mjetet realizohen brenda vitit; *Ndërtimi i sheshit “Hasan Prishtina”*, mjetet janë bartur për këtë vit, ndërsa komuna është vonuar për lejimin e pronës. Projekti *Varrezat e Dëshmorëve në Marinë*, kanë qenë 110 mijë euro, ndërsa është paraparë edhe dërgimi i ujësjellësit prej Prekazi dhe buxheti është rritur në 220 mijë euro.

Në *Memorialin “Ibrahim Rugova”* nuk janë realizua dhe mjetet e planifikuara (200 mijë euro), me kërkesën e Komisionit për Buxhet dhe Financa, janë bartur te *projekti për Memorialin “Ibrahim Rugova” në Istog*, pasi që nuk kanë mundur të realizohen mjetet. *Projekti për Memorialin “Ibrahim Rugova”* në Prishtinë, është një ndër pikat më problematike për momentin, sepse aty kemi tani, përveç varrit të Ibrahim Rugovës, edhe varrin e Adem Demaçit, Ahmet Krasniqit, Ilir Konushevcit, varret e dëshmorëve dhe veteranëve dhe varrimi është bërë pa një kriter të qëndrueshëm dhe se agjencia ka qenë e pafuqishme për këtë. Prandaj, kërkoi që të bëhet një projekt më madhështor dhe reprezentativ për Kosovën, ku në të duhet të përfshihen, përveç Komunës së Prishtinës, MMPH-ja, MKRS-ja, shoqatat e dala nga lufta, banorët e lagjes edhe ekspertë të fushave përkatëse.

Për projektin *Kompleksi Memorial “Adem Jashari” në Prekaz*, për vitin 2018, tregoi se janë ndarë 1 milion euro, ndërsa janë shpenzuar 213 mijë euro. Sa i përket projektit që ka kushtuar 600 mijë euro, ai është bërë më herët dhe është llogaritur vetëm për konservimin e kullave të rezistencës. Në 2017 dhe 2018, agjencia nuk ka reaguar. Në javën e parë të mandatit, drejtori i ka ofruar këto mjete kryetarit të komunës, mirëpo është pritur të miratohet ligji i ri për Kompleksin “Adem Jashari” dhe për vlerësimin e projektit do të formohet një komision. Do të insistohet që të implementimet projekti i konservimit, i punuar nga një kompani sllovene e të

vërtetuar nga një kompani e Shqipërisë, për plotësimin e kushteve të projektit, ndërsa varet nga Komiteti Ndërministror, a do ta pranojë këtë, tha drejtori Zogaj.

Salih Zyba, tha se në raportimin e parë, ka kërkuar listën e memorialëve, për krahasim se ku është investuar e ku jo. U pajtua me propozimin e deputetes Ganimete Musliu, për komisionin hetimor parlamentar dhe pyeti drejtorin, nëse e konsideron të nevojshëm formimin e këtij komisioni. Pastaj pyeti: A ka penalizim për keqbërje ose edhe moskryerje të punëve, në këto projekte? Gjithashtu, shprehu shqetësimin për pafuqinë e drejtorit të agjencisë, në lidhje me rivarrimet e fundit dhe tha se kjo çështje duhet të adresohet.

Ganimete Musliu, Po ashtu, shprehu shqetësimin për pafuqinë e drejtorit dhe të agjencisë, në lidhje me 4 rivarrimet e fundit në Memorialin “Ibrahim Rugova”. **Liburn Aliu**, pyeti për obeliskun për Afrim Zhitinë: Pse nuk është bartur ky projekt, në kuadër të agjencisë?

Bislim Zogaj, tha se të gjitha projektet që kanë qenë, në kuadër të MMPH-së, janë bartur te agjencia, mirëpo projekti për Afrim Zhitinë, për shkak të uzurpimit të një prone, ministria nuk e ka bartur, derisa ta zgjidhë këtë. Sa i përket penalizimit dhe masave të ndërmarra, shtoi se kanë qenë personalitete dhe nuk e di se kush kishte mundur të ndërmarrë masa. Në fund, ai kërkoi edhe ndihmën e komisionit parlamentar për këto çështje dhe kërkoi mbështetjen për lejimin e pranimit të punëtorëve të rinj në agjenci.

Besa Gaxherri, zëvendëskryetare, duke e falënderuar z. Zogaj për raportin, e përfundoi mbledhjen e komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 11:50.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Muharrem Nitaj